



ANGAZHIMI I MENAXHERIT TE LARTE PER PAANSHMERINE

Kodi TCPE-FO-4.3.1

Version: 2

Data Efektive: 09.05.2023

Faqe: 1 – 1

Unë Administratori dhe punonjësit e Trupës Çertifikuese TCPE, kuptojnë rëndësinë e integritetit, paanësisë dhe konfliktit të mundshëm të interesave në kryerjen e proceseve të certifikimit, dhe implementimit të sistemit të menaxhimit, në përputhje me kërkesat e Standardit ISO/IEC 17024:2012.

Paanshmëria është një nga vlerat thelbësore të Trupës Çertifikuese TCPE dhe një pjesë kyçe e Kodit të Etikës. Ruajtja e paanshmërisë së aktiviteteve të ofruara nga Trupa Çertifikuese TCPE, në certifikimin e personit, është çelësi për mbrojtjen e besueshmërisë në procesin e certifikimit të personit, duke siguruar kënaqësinë e personave të certifikuar dhe të palëve të treta të interesuara.

Trupa Çertifikuese TCPE, synon të frymëzojë besimin për klientët e saj, përmes implementimit të programit të certifikimit, në përputhje me kërkesat e sistemit të menaxhimit, duke qenë: të paanshëm; duke siguruar punonjës kompetentë; duke iu përgjigjur ankesave; duke siguruar qasje në informacionin përkatës të mbledhur; duke qenë të hapur, paanësinë; transparencën e proceseve dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

Menaxhmenti i Trupës Çertifikuese TCPE, kryen vlerësimin vjetor të rrezikut mbi paanëshmërinë, pavarësinë dhe konfliktin e interesit, dhe kjo do të rishikohet vazhdimisht nga Komiteti i Paanshmërisë, i cili është një Komitet i pavarur i përbërë nga anëtarë që përfaqësojnë të gjitha palët e interesuara, pa mbizotrim interesi.

Konflikti i interesit dhe objektiviteti adresohet në marrëveshje të detyrueshme kontraktuale, kështu që Trupa Çertifikuese TCPE, nuk do të ofrojë trajnime në lidhje me kandidatët e skemave të certifikimit, në mënyrë që të gjitha aktivitetet e certifikimit, të sistemit të menaxhimit, do të kryhen në mënyrë të paanshme.

Trupa Çertifikuese TCPE, vlerëson financat dhe burimet e të ardhurave dhe demonstroi se presionet tregtare, financiare dhe të tjera nuk e cenojnë paanshmërinë e tij në çdo kohë.

Anëtarët dhe ekspertët e jashtëm të këtyre komiteteve të krijuara në kuadër të implementimit të programit të certifikimit, u kërkohet të ruajnë paanshmërinë e tyre, gjatë ushtrimit të funksionit në aktivitetet e certifikimit dhe u kërkohet të nënshkruajnë deklaratë konfidencialiteti.

ADMINISTRATORI

Xhevdet Kacani